



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:112245

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05832345

C.nr.2099/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Berat Spahiu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.B nga Gjilani, kundër të paditurve F.B nga Gjilani, Rruga „...” III/2 nr. 15 dhe i padituri E.B nga Gjilani, rruga „...” ..., banesa nr. 84. me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë nga baza e trashigimisë, jashtë seancës gjyqësore, më datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit B.B nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurve F.B nga Gjilani dhe të paditurit E.B nga Gjilani, me objekt të kontestit, vërtetimi i pronësisë nga baza e trashigimisë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi B.B nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim Av. Elmi Qerimi nga Gjilani, me parashtrësën e datës 22.02.2024, ka bërë rregullimin e padisë, ashtu që në vend të paditëses A.B, procedurën e ka vazhduar paditësi B.B nga Gjilani, kurse si të paditur ka pëcaktuar të paditurin F.B nga Gjilani dhe E.B nga Gjilani.

Gjykata, ka caktuar seancë përgatitore lidhur me këtë çështje për datë 12.04.2024 dhe në atë seancë gjyqësore ka marrur aktvendim procedural, ashtu që ka detyruar përfaqësuesin e paditësit, av. Elmi Qerimi, që në afat prej 10 ditësh të rregullojë padinë sa i përket vlerës së objektit të kontestit, e cila për bazë ka vlerën e vlerësuar në procedurë trashëgimore prej 60,000.00 Euro dhe për këtë të paguajnë taksën gjyqësore, e po ashtu të përcaktojnë saktë palët në procedurë dhe kërkesat e tyre, gjithmonë duke pasur parasysh aktvdekjen që gjendet në shkresat e lëndës, e cila është e përpiluar më dt. 29.08.2013, ku si trashëgimtarë të të ndjerit M.B janë shpallur I.I, F.B, A.B, G.D dhe A B, e që sipashkresave të lëndës tani në jetë nuk janë trashëgimtarët A.B dhe A.B, ashtu që sipas të drejtës së përfaqësimit në vend të tyre hyjnë fëmijët e tyre. Po ashtu, gjykata ka kërkuar që për të ndjerën M.H duhet të paraqitet dokumentacioni për trashëgimtarët e saj, në mënyrë që gjykata të njëjtëve t’ua dërgojë aktvendimet për përgjigjet në padi dhe më pas edhe ftesat dhe shkresat e tjera. Po ashtu, gjykata i ka tërhequr vërejtjen paditësit, rrespektivisht përfaqësuesit të tij, se gjatë rregullimit të padisë të kihet parasysh edhe fakti se trashëgimtarët në këtë kontest janë bashkëndërgjyqës unik dhe të domosdoshëm në një procedurë dhe të gjithë duhet të jenë të përfshirë si palë, së paku në aspektin pasiv dhe se përfaqësuesi i palës paditëse ka kuptuar pasojat e mosveprimit, konform vendimit të gjykatës. Përfaqësuesi i paditësit as pas kalimit të afatit gjyqësor, nuk e ka

rregulluara padinë në aspektin subjektiv, as nuk ka paguar taksën shtesë për padi konform vlerës së kontestit prej 60,000.00€, ashtu që në këtë situatë, gjykata duke pasur parasysh obligimin e paditësit, konform nenit 102.1 të LPK-së ku është përcaktuar se „ Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës. Në nenin 102.3 të LPK-së është përcaktuar se „Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë” ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

Nga të cekurat më lart e në bazë të nenit 116.1, 116.5, 142.5, 409.1 dhe 452.4 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:112245, 18.06.2024

Gjyqtari
Berat Spahiu

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.